



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 510/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Adnan Konushevci dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e koalicionit NISMA-AKR-PD, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më 24.11.2019, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa Anr. 510/2019 e datës 24.11.2019, e paraqitur nga koalicionit NISMA-AKR-PD, me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) - Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), me të cilën ka kërkuar që të shpallet i vlefshëm një fletëvotim në Vendvotimin 2070B/01R.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 24.11.2019, ka pranuar një ankesë Anr.510/2019 nga koalicionit NISMA-AKR-PD, në të cilën pretendohet se më 23.11.2019 rreth orës 19:00 në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), gjatë numërimit të votave në kutinë e votimit 2070B/01R është shpallur një fletëvotim i vlefshëm pa të drejtë nga zyrtarët e QNR-së, dhe në kundërshtim me Doracakun e Procedurave të Votimit dhe Numërimit të KQZ-së, sepse në këtë fletëvotim në rubrikën me numër 126 të subjektit politik LVV, ka disa numra si: 1, 2, 6, 10, dhe 60 dhe se në të njëjtën rubrikë nuk ka asnjë tik ose shenjë nga votuesi.

Sipas parashtruesit të ankesës shenjat të cilat janë shënuar në fletëvotimin 2070B/01R, nuk kanë të bëjnë me qëllimin e votuesit dhe e njëjta duhet të shpallet e të pavlefshme.

Në përgjigjen në ankesë të datës 24.11.2019, të KQZ-së thekson se në vendvotimin 2070B/01R fletëvotimi është shpallur i vlefshëm për arsye se tek subjekti politik me numër 126 votuesi ka shënuare “numra” në kolonën e subjektit e cila e bën të qartë qëllimin e votuesit.

PZAP-i, pas shqyrtimit të ankesës, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura dhe sipas hetimit të kryer nga vet PZAP, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Nga shkresat e lëndës konstatohet se në kutinë e votimit: 2070B/01R është e shpallur i vlefshëm 1 fletëvotim nga ana e QNR-së në të cilin shihet se ka disa numra si: 1, 2, 6, 10, dhe 60 ndërsa shenja tik nuk është shënuar në katrorin subjektiv politik LVV. Si rezultat i këtyre konstatimeve QNR-ja, me rastin e numërimit e ka shpallur të vlefshëm këtë fletëvotim.

Koalicioni NISMA-AKR-PD, si palë ankuese ka paraqitur ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1 të LZP-së, brenda afatit ligjor ku ka kërkuar nga PZAP-i, që ky fletëvotim të shpallet i pa vlefshëm sepse të metat apo gabimet të cilat i referohet QNR-ja janë kritere që e bëjnë të pa vlefshëm një fletëvotim.

Paneli, me rastin e vendosjes së ankesës dhe përgjigjes në ankesë ka formuar ekipin hetues dhe ka dërguar në QNR, për të zhvilluar hetime në raport me pretendimet e cekura nga ankuesi. Pas përfundimit të hetimit në QNR, ekipi hetues ka gjetur se nuk qëndron pretendimi i ankuesit se fletëvotimi i gjetur në kutinë e votimit 2070B/01R duhet të shpallet i pavlefshëm për shkak të mos përmbushjes së kritereve për të qenë e vlefshme e njëjta.

Në fletëvotimin që është ekzaminuar shihet se shenja tik mungon mirëpo në kolonën në të cilën qëndron subjekti LVV, janë shënuar numrat e kandidatëve ku ka të bëjë me vullnetin e votuesit. Kështu që Paneli ka shpallur të vlefshëm këtë fletëvotim, pasi që nga ekzaminimi i të njëjtit ka rezultuar se i përmbush kriteret e vlefshmërisë, dhe duhet t'i bashkëngjitet rezultatit përfundimtar të publikuar me datë 07.11.2019.

PZAP-i, më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura vendimin e ka bazuar në nenin 119 paragrafi 5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, Paneli në kuptim të nenit 117, 118 dhe nenit 120 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 510/2019 më datën 24.11.2019



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.